



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
Qendra për Çështje Europiane & të Sigurisë

European Fund for the Balkans

Bringing the Western Balkans closer to the European Union

Historitë pas liberalizimit të vizave: azilkërkuesit dhe migrimi i paligjshëm

Shkurt 2013



Përgatitur nga:

Egest Gjokutaj

Elira Hroni

Mbështetur nga:

EUROPEAN FUND FOR THE BALKANS

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të European Fund for the Balkans.

Përmbajtja e lëndës

Lista e Shkurtimeve.....	4
Përmbledhje ekzekutive.....	
Hyrje.....	7
Metodologjia.....	9
Tendencat e kërkesave për azil të shqiptarëve në vendet e BE-së gjatë 2011-2012..	11
Perspektiva nga azilkërkuesit shqiptarë në Belgjikë, Francë dhe Greqi.....	5
Strategjia për ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Rikthyer dhe Plani i Veprimit..	22
<i>Strategjia</i>	22
<i>Analizë e planit të veprimit</i>	22
Rekomandime.....	25
Shtojca 1: Analizë e detajuar e planit të veprimit.....	27
Literatura.....	39

Tabelat dhe grafikët

Tabela 1: Kërkesat e reja për azil të shqiptarëve në vendet e BE-së 2011-qershor 2012...	11
Tabela 2: Kërkesat për azil nga Shqipëria: 3 vend-destinacionet kryesorë 2011-qershor 2012.....	12
Tabela 3: Vendimet e shkallës së parë për aplikimet për azil të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së (2011).....	14
Tabela 4: Arsyet që kanë ndikuar për të kërkuar azil në vendin përkatës sipas vendeve..	18
Tabela 5: Arsyet që i paraqiten autoriteteve kur aplikohet për azil sipas vendeve.....	20
Grafiku 1: Kërkesat për azil nga Shqipëria në Belgjikë, Greqi dhe Francë (janar 2011-korrik 2012).....	13
Grafiku 2: Përfaqësimi gjinor i të gjithë kampionit.....	15
Grafiku 3: Përfaqësimi moshor i të gjithë kampionit	15
Grafiku 4: Të intervistuarit nga zonat urbane dhe rurale për të gjithë kampionin.....	16
Grafiku 5: Niveli arsimor i të gjithë kampionit.....	16
Grafiku 6: Arsyet që kanë ndikuar për të kërkuar azil në vendin përkatës: i gjithë kampioni.....	17
Grafiku 7: A jeni informuar paraprakisht për vendin që keni aplikuar për azil: kampioni total.....	19
Grafiku 8: Burimet e informacionit përpara migrimit: kampioni total.....	19
Grafiku 9: Arsyet që i paraqiten autoriteteve kur aplikohet për azil: i gjithë kampioni.	20

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
DP	Drejtori e Përgjithshme
KE	Komisioni Evropian
MLV	Marrëveshje për Liberalizimin e Vizave
MBUK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MF	Ministria e Financave
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PKM	Polica e Kufirit dhe Migracionit
PKK	Pikat e Kalimit të Kufirit
SM	Sportelet e Migracionit
UNHCR	Komisioneri i lartë i OKB për Emigrantët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZRP	Zyrat Rajonale të Punësimit



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pas miratimit të Marrëveshjeve të Ri-pranimit dhe thujse dy vjet pas ratifikimit të Marrëveshjeve për Lehtësimin e Vizave (MLV), Bashkimi Evropian (BE) vendosi liberalizimin e vizave fillimisht për Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi në dhjetor të vitit 2009 dhe një vit më pas edhe për Bosnjë Hercegovinën dhe Shqipërinë. Pas vendosjes së liberalizimit të vizave qindra qytetarë të Maqedonisë dhe Serbisë udhëtuan drejt shteteve të BE-së për të kërkuar azil. Edhe pse jo me të njëjtin ritëm, prurjet e azilkërkuesve shqiptarë drejt vendeve të BE-së janë rritur që prej gjysmës së dytë të vitit 2011. Për t'u përballur me sfidat e procesit të liberalizimit të vizave, qeveria shqiptare ndërmori fushata informuese për qytetarët mbi të drejtat dhe detyrimet në kuadër të liberalizimit të vizave në maj të vitit 2010 si edhe miratoi Strategjinë për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Ri-kthyer 2010-2015 dhe Planin e Veprimit në qershor të po atij viti. Edhe pse është vlerësuar pozitivisht, strategjia u hartua brenda një kohe të shkurtër dhe nuk u konsultua gjerësisht me aktorë si shoqëria civile, ekspertë të pavarur dhe grupet përkatës të interesit. Si rrjedhojë asaj i mungojnë instrumentet e përshtatshëm për trajtimin e dinamikave të menaxhimit të migrimit dhe ri-integrimit. Për të pasur një kuadër ligjor dhe institucional funksional dhe që trajtojnë në mënyrën e duhur sfidat e menaxhimit të emigrimit dhe ri-integrimit, nevojitet identifikimi dhe analizimi i arsyeve kryesore që qëndrojnë pas kërkesave për azil.

Përvoja e azilkërkuesve shqiptarë që u intervistuan për këtë studim në Belgjikë, Francë dhe Greqi nxjerr në pah se arsye si procedurat e përshpejtuara të azilit, përmbushja me lehtësi e kriterëve të vendosura prej autoriteteve të vendeve pritëse dhe hyrja lehtësisht në vendin ku aplikohet për azil, përbëjnë 'motivimet' kryesore që azilkërkuesit të synojnë këto vende. Për sa i përket faktorëve shtytës për të aplikuar për azil, arsyet që iu janë prezantuar autoriteteve nga të intervistuarit në tre vendet e sipër përmendura tregojnë se arsyet ekonomike janë mbizotëruese. Megjithatë, kjo tendencë është më e dukshme në Greqi ndërsa në Francë dhe Belgjikë një numër i konsiderueshëm të intervistuarish thonë se kanë aplikuar për azil sepse kërcënoheshin prej gjakmarrjes.

Bazuar në vlerësimin e masave të përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Rikthyer, ky studim rekomandon ndërmarrjen e masave efikase që synojnë menaxhimin e emigrimit dhe mbështetjen e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer. Së pari, masat që përfshihen në plan-veprim duhen rishikuar dhe përditësuar për t'u përshtatur me zhvillimet aktuale. Së dyti, masat me karakter informues duhet të reduktohen dhe zëvendësohen me ndërhyrje konkrete për trajtimin e nevojave të shtetasve të rikthyer. Së fundmi, duhen hartuar programe specifike në përgjigje të nevojave të shtetasve të ri-kthyer në fusha si shëndetësia, arsimi, strehimi, nxitja e punësimit, trajnimet profesionale dhe ndihma ekonomike.



HYRJE

Dialogu për liberalizimin e vizave u zhvillua përgjatë periudhës 2008-2010 ndërmjet Komisionit Evropian (KE)¹ nga njëra anë dhe Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi nga ana tjetër. Ai u përmbyll duke përfshirë 5 shtetet e Ballkanit perëndimor në listën e vendeve që nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në territorin e BE-së. Gjatë viteve 2008 dhe 2009 KE iu dorëzoi qeverive përkatëse Udhëzuesin për Liberalizimin e Vizave. Udhëzuesi organizohej sipas katër blloqeve:

1. Siguria e dokumenteve,
2. Emigracioni i paligjshëm dhe ripranimi,
3. Rendi Publik dhe Siguria, dhe
4. Marrëdhëniet e Jashtme dhe të drejtat e njeriut.²

Pas paraqitjes së vlerësimeve me shkrim mbi ecurinë e përmbushjes së kriterëve të Udhëzuesit prej qeverive përkatëse, raporteve të monitorimit dhe misionëve në terren prej KE dhe shteteve individuale të BE-së, Marrëveshjet për Liberalizimin e Vizave u vendosën së pari me Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi në vitin 2009 dhe një vit më pas edhe me Shqipërinë dhe Bosnjë Hercegovinën.³ MLV përfshin qytetarët e vendeve pjesë të procesit të pajisur me pasaporta biometrike, të cilët mund të udhëtojnë drejt vendeve të BE-së pa viza për një periudhë 90 ditore brenda gjashtë muajve. Pavarësisht kësaj, ata i nënshtrohen kushteve për hyrjen në vendet e BE-së që përcaktohen nga Kodi Kufitar i Shteteve Schengen (Schengen Border

1. Komisioni Evropian (KE) është një nga institucionet kryesore vendimmarrëse të BE-së. Ai përbëhet nga 27 Komisionerë dhe është i organizuar sipas Departamenteve të Përgjithshme (DP). Lidhur me liberalizimin e vizave, nëpërmjet DP të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme dhe atij të Zgjerimit, KE monitoron zbatimin, organizon konsultime emergjente dhe mund t'i propozojë Këshillit masa, të cilat mund të përfshijnë edhe pezullimin e liberalizimit të vizave për një ose disa vende në raste abuzimesh. http://ec.europa.eu/about/ds_en.htm

2. European Commission 'Third Report on the Post-Visa Liberalization Monitoring for the Western Balkan Countries in Accordance with the Commission Statement of 8 November 2010.', fq.2

3. Council Decision 15521/09 'Council regulation amending Regulation (EC) No. 539/2001 listing third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement.' and Decision 15875/10 'Visa Liberalization for Albania and Bosnia Herzegovina.'

Code) dhe mund të refuzohen prej autoriteteve kufitare të vendeve të BE-së në rast mosplotësimi të këtyre kriterëve.⁴ Për të monitoruar zbatimin e MLV-së në pesë vendet e përfshira, në vitin 2010 BE-ja hartoi një mekanizëm monitorues dhe që prej atëherë janë hartuar 3 raporte monitorimi.

Pas hyrjes në fuqi të MLV-së, numri i aplikimeve për azil drejt vendeve të BE-së nga Serbia dhe Maqedonia u rrit dukshëm. Kështu në vitin 2010, kërkesat për azil nga Serbia drejt vendeve të BE-së u rritën nga 320 në janar në 1660 në dhjetor, ndërkohë që për të njëjtin vit aplikimet për azil nga Maqedonia u rritën nga 65 në janar në 1125 në nëntor.⁵ Në vitin 2011 hyrja në fuqi e MLV-së me Shqipërinë nuk u shoqërua menjëherë me rritje të azilkërkuesve drejt vendeve të BE-së. Megjithatë në tetor 2011 Belgjika u ankua për valë të pa-precedent azilkërkuesish shqiptarë, të cilët aplikonin duke pretenduar se ishin viktime të fenomenit të gjakmarrjes.⁶ Drejtori i Departamentit të Azilit dhe Emigracionit të Belgjikës Z. Freddy Roosemont vizitoi Tiranën në tetor të vitit 2011 duke deklaruar se "Prapa atyre që kërkojnë azil fshihen organizata dhe rrjete kriminale që pajisin ata me certifikata gjakmarrjeje të falsifikuara kundrejt një shume parash.⁷ Në vazhdim, raportet mediatike për raste kur disa organizata që merren me pajtimin e gjaqeve lëshonin certifikata gjakmarrjeje të falsifikuara kundrejt parave bënë që autoritetet shqiptare të fillonin ndjekjen penale ndaj drejtuesve të tyre. Megjithatë, edhe pse mbulimi mediatik ka kontribuar për të sjellë këtë fenomen në vëmendjen e opinionit publik, përgjigja e autoriteteve shqiptare duket se ka qenë sporadike, e kufizuar dhe vetëm kur është kërkuar me ngulm prej Komisionit Evropian ose prej ndonjë vendi anëtar të caktuar.⁸

Në përgjigje të sfidave që burojnë nga procesi i liberalizimit të vizave,

4. Chachipe, 'Selective Freedom: The Visa Liberalizations and Restrictions on the Right to Travel in the Balkans.' fq.3

5. European Commission 'Second Report on Post-Visa Liberalization Monitoring in Accordance with the Commission Statement of 8 November 2010.' June 2012, fq. 21-23

6. Gjakmarrja dhe hakmarrja janë pjesë të Kanunit, i cili është një grup normativash të ligjit të pashkruar që përdorej në veriun e Shqipërisë të paktën që prej shekullit të pesëmbëdhjetë e deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore Gjakmarrja u riaktivizua gjatë tranzicionit shqiptar dhe që prej atëherë ka prodhuar shumë shqetësime ekonomike dhe shoqërore sidomos në veri të vendit. Ndërsa sipas normave tradicionale gjaku merret vetëm tek meshkujt e familjes, rastet e pas viteve 1990 kanë përfshirë në gjakmarrje edhe gra e fëmijë. Kjo bërë që familje të tëra të ngujohen, fëmijët të braktisin shkollën duke përkeqësuar edhe më shumë kushtet e jetesës për familje, të cilat edhe më parë kanë qenë të varfra. Gjatë procesit të liberalizimit të vizave shumë shqiptarë kanë kërkuar azil bazuar tek kërcënimi prej gjakmarrjes. Ky studim e shikon gjakmarrjen brenda këtij konteksti.

7. EU Business, 'Foul Play Behind Surge in Albanian Asylum Seeking' 18 October 2011

8. Frontex 'Western Balkans Annual Risk Assessment 2011', fq.32

qeveria shqiptare ndërmori fushata informuese gjatë viteve 2008 dhe 2009 si dhe miratoi në qershor 2010 Strategjinë për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Rikthyer dhe Planin e Veprimt. ⁹ Edhe pse është vlerësuar si një instrument pozitiv, strategjia u hartua me shpejtësi dhe pa kaluar në një proces konsultimi me aktorë nga shoqëria civile, ekspertë të pavarur, grupe përfituesish dhe grupe të tjerë interesi. Ky studim analizon përqasjen e qeverisë shqiptare për planifikimin dhe zbatimin e masave parandaluese dhe penguese si dhe dobishmërinë e tyre duke pasur parasysh situatën aktuale dhe dinamikat e zhvillimit të procesit të menaxhimit të migrimit dhe ri-integrimit. Ai identifikon dhe analizon rastet e keqpërdorimit të regjimit të liberalizimit të vizave dhe arsyet që diktojnë këto praktika. Bazuar në evidencën e mësipërme së fundmi studimi paraqet disa alternativa të mundshme dhe rekomandime për pasjen e një kuadri politikash dhe masash që synojnë trajtimin e arsyeve kryesore të fenomenit.

METODOLOGJIA

Ky studim synon të identifikojë dhe analizojë arsyet kryesore, ndikimin, mungesat dhe problematikën lidhur me masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare si reagim ndaj shqetësimeve në rritje për keqpërdorim të regjimit të liberalizimit të vizave me BE-në. Studimi analizon të dhënat zyrtare dhe ato alternative mbi këtë fenomen, perspektivën e shtetasve shqiptarë që kanë aplikuar për azil si edhe kuadrin institucional, ligjor dhe të politikave që synon të parandalojë dhe trajtojë sfidat. Gjithashtu, studimi mundëson të dhëna sasiore dhe cilësore, të cilat analizohen më tej në kontekstin më të gjerë të informacionit të grumbulluar. Kësisoj synohet gjenerimi i rekomandimeve politike për një kuadër të qartë masash që mundësojnë ndikim të qëndrueshëm për menaxhimin e migrimit dhe ri-integrimin.

Kapitulli i parë i këtij studimi përqendrohet tek analiza e statistikave mbi të dhënat për aplikimet për azil të qytetarëve shqiptarë dhe prirjet e regjistruara përgjatë periudhës 2011-2012 bazuar në burime si Eurostat dhe Frontex. Gjithashtu, janë mbledhur të dhëna të tjera nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar të zhvilluar me azilkërkuesit shqiptarë që kanë aplikuar për azil gjatë periudhës janar 2011-qershor 2012 dhe që janë ende në territorin e BE-së duke pritur vendimin përfundimtar për kërkesat e tyre. Për kryerjen e intervistave, janë përzgjedhur tre vende me prurje të lartë

9. Republika e Shqipërisë, 'Strategjia për Ri-Integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Rikthyer 2010-2015.' Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 95 Tiranë 23 korrik 2010, fq. 5063

azilkërkuesish shqiptarë gjatë liberalizimit të vizave: Belgjika, Franca dhe Greqia. Ndërsa në Greqi (15 intervista) dhe Francë (10 intervista) u arrit numri i synuar i intervistave, në Belgjikë për shkak të vështirësive për identifikimin e azilkërkuesve u zhvilluan vetëm shtatë intervista.

Pjesa e dytë e studimit analizon kuadrin politik për menaxhimin e shtetasve shqiptarë të ri-kthyer dhe ri-integrimit të tyre. Evidenca kryesore për këtë pjesë është marrë nga Raporti i Monitorimit për Zbatimin e Planveprimit të Strategjisë për Ri-integrimit të Shtetasve Shqiptarë të Rikthyer (qershor 2010-dhjetor 2011) si edhe nga raporti me treguesit e zbatimit të strategjisë dhe plan veprimit (korrik 2010-dhjetor 2011), të cilat u ofruan nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Masat specifike të zbatuara nga institucionet shqiptare vlerësohen lidhur me efikasitetin, përputhshmërinë dhe ndikimin që gjenerojnë për trajtimin e dinamikave të migrimit, parandalimit të azilit të paligjshëm dhe ri-integrimit të shtetasve të ri-kthyer. Së fundmi studimi mbyllet me disa rekomandime për të përmirësuar reagimin e autoriteteve shqiptare kundrejt sfidave që burojnë nga liberalizimi i vizave me BE-në.

Kufizimet

Ky studim synonte fillimisht të analizonte të dhënat e mbledhura nga autoritetet shqiptare lidhur me rastet e keqpërdorimit të procesit të liberalizimit të vizave prej qytetarëve shqiptarë gjatë periudhës janar 2011-korrik 2012 (ose edhe më tej gjatë vitit 2012, në rastet kur ishte e mundur). Për të arritur këtë u kontaktua me Policinë e Kufirit dhe Migracionit (PKM) lidhur me mundësimin e të dhënave mbi shtetasit e rikthyer në kufi. Bashkëpunimi me këtë strukturë ka qenë i vështirë dhe në fund PKM nuk ka mundur të dhënat e kërkuara duke theksuar se ato janë konfidenciale. Prandaj, pjesa e parë e studimit bazohet kryesisht tek të dhënat dytësore dhe disa prej çështjeve janë trajtuar pjesërisht. Ky fakt përbën një kufizim të këtij studimi, i cili meriton vëmendjen e studimeve të ardhshëm të kësaj natyre.



TENDENCAT E KËRKESAVE PËR AZIL TË SHQIPTARËVE NË VENDET E BE-SË GJATË 2011-2012

Liberalizimi i vizave me Shqipërinë nuk u shoqërua menjëherë me rritje të azilkërkuesve sikundër në rastet e Serbisë dhe Maqedonisë.¹⁰ Gjatë vitit 2010, aplikimet për azil nga shtetasit shqiptarë drejt vendeve të BE-së u ul nga 1310 në 1090.¹¹ Megjithatë, prurjet e azilkërkuesve shqiptarë drejt vendeve të BE-së u rritën që prej gjysmës së dytë të vitit 2011. Sipas UNCHR kërkesat për azil të shtetasve shqiptarë drejt vendeve të BE-së u rritën nga 1820 në vitin 2010 në 2822 në vitin 2011.¹² Të dhënat nga Eurostat theksojnë se kërkesat për azil të shtetasve shqiptarë drejt vendeve të BE-së u rritën nga 110 në janar të vitit 2011 në 235 në nëntor të po të njëjtit vit. Gjatë kësaj periudhe rritjet më të mëdha në kërkesa shtetasve shqiptarë drejt vendeve të BE-së vërehen në qershor-tetor 2011 (+580) në dhe shkurt-maj 2012 (+755).

Tabela 1: Kërkesat e reja për azil të shqiptarëve në vendet e BE-së 2011-qershor 2012²³

3-M	2011 T1			2011 T2			2011 T3			2011 T4			2012 T1			2012 T2		
Muaj	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9	M10	M11	M12	M1	M2	M3	M4	M5	M6
Shqip.	110	125	145	185	150	145	185	150	265	725	355	280	235	225	320	395	980	535

Burimi: Eurostat: Të dhëna (të rrumbullakosura) mujore për aplikantët azilkërkues dhe të rinj azilkërkues sipas shtetësisë, moshës dhe gjinisë

10. Në vitin 2010 Serbia renditej vendi i tretë me numrin më të madh të azilkërkuesve drejt vendeve të BE-së, Maqedonia renditej e 9-ta, ndërsa Shqipëria e 30-ta. European Stability Initiative, 'Presentation: Freedom of Movement in a Populist Age: Why Balkan Visa Liberalization Is (Still) a Success.' 1 korrik 2011, fq.2

11. Chachipe, 'Selective Freedoms: The Visa Liberalization and Restrictions to Travel in the Balkans', korrik 2012, fq.52

12. UNCHR, 'Asylum Levels and Trends in Industrialized Countries, 2011' 2011 fq.24

13. Eurostat përkufizon kërkesat e reja për azil si kërkesat që kryhen prej atyre që aplikojnë për herë të parë për azil.

Sipas statistikave të Eurostat, Belgjika, Franca dhe Greqia janë 3 vendet e BE-së që kanë regjistruar fluksin më të lartë të kërkesave për azil prej shtetasve shqiptarë gjatë periudhës janar 2011-qershor 2012. Në vitin 2011, kërkesat për azil të shtetasve shqiptarë në të tre vendet e marra së bashku (1950) përbënin thuhajse $\frac{3}{4}$ e të gjithë kërkesave për azil që janë bërë nga shtetasit shqiptarë në vendet e BE-së (2850) (tabela 2). Belgjika (1180) është shteti me numrin më të lartë të kërkesave për azil gjatë vitit 2011. Kjo tendencë vjen për shkak të keq-perceptimit të sistemit të azilit të vendit, mundësisë për t'u pajisur lehtësisht me certifikata gjakmarrjeje, përpjekjeve të azilkërkueseve për të përfituar financiarisht prej rikthimit vullnetar si dhe nga përhapja gjerësisht e fjalëve se azilkërkuesit kanë të drejtë të punësohen në Belgjikë.¹⁴

Tabela 2: Kërkesat për azil nga Shqipëria: 3 destinacionet kryesore 2011-qershor 2012

Vendet	Azilkërkuesit shqiptarë viti 2011	Azilkërkuesit shqiptarë janar-korrik 2012
BE	2850	3385
Belgjikë	1180	180
Greqi	280	165
Francë	490	830

Burimi: Eurostat: Të dhëna (të rumbullakosura) mujore për aplikantët azilkërkues dhe të rinj azilkërkues sipas shtetësisë, moshës dhe gjinisë

Tendencat mujore të kërkesave për azil nga qytetarët shqiptarë në Belgjikë, Francë dhe Greqi ritheksojnë se rritja më e madhe e kërkesave për azil ka ndodhur gjatë gjysmës së dytë të vitit 2011. Gjatë kësaj periudhe në Belgjikë kërkesat për azil nga shtetasit shqiptarë u rritën nga 25 në qershor në 530 në tetor ndërsa në Greqi dhe Francë kjo rritje ka qenë më e vogël.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 vërehet rënie e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë në Belgjikë (nga 1180 në 180), dhe Greqi (nga 280 në 165) (Grafiku 1).


Rënia e kërkesave për azil nga shtetasit shqiptarë në Belgjikë gjatë vitit 2012 konfirmohet gjithashtu edhe nga autoritetet belge që theksojnë se kërkesat për azil kanë rënë nga 809 në vitin 2011 në 194 në maj të vitit 2012.¹⁵ Kjo tendencë mund të jetë pasojë e rritjes së përpjekjeve të përbash-

14. Frontex, 'Western Balkans annual risk assessment 2011' April 2012, fq.17

15. Office of the Commissioner General for Refugees and stateless persons, 'Asylum statistics Monthly Report' May 2012, fq.6

këta të autoriteteve belge dhe shqiptare. Operacioni i parë i kthimit nga Belgjika u ndërmor fill pas vizitës së Drejtorit të Drejtorisë së Migrimit të Belgjikës Freddy Rosemont në tetor 2011 dhe operacione sporadike për rikthimin e azilkërkuesve shqiptarë nga Belgjika janë ndërmarrë edhe gjatë vitit 2012.¹⁶

Grafiku 1: Kërkesat për azil nga Shqipëria në Belgjikë, Greqi dhe Francë (janar 2011-korrik 2012)



Burimi: Të dhëna (të rumbullakosura) mujore për vendimet e shkallës së parë për aplikimet sipas nënshtetësisë, moshës dhe gjinisë

Rënia e kërkesave për azil prej shtetasve shqiptarë në Greqi gjatë 2012 mund të jetë pasojë e rënies së emigrimit qarkullues shqiptar për motive punësimi në këtë vend si rrjedhojë e mundësive të pakta për punë. Gjithashtu, hapja e kanaleve të rinj të migrimit nga procesi i liberalizimit të vizave iu mundësoi emigrantëve potencialë shqiptarë diversifikimin e destinacioneve të tyre në vende me mundësi punësimi më të shumta se në Greqi.¹⁷

16. Gazeta Shekulli online, 'Belgjika rikthen në Tiranë 51 azilkërkues' 24 tetor 2012

17. Frontex, 'Fran quarterly 2012' Issue 2 April-June 2012, fq.32-37

Tabela 3: Vendimet e shkallës së parë për aplikimet për azil të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së (2011)

Shtetet	Vendime të pranuar	Vendime të refuzuar	Vendime totale
BE	250	1760	2010
Belgjikë	30	415	445
Danimarkë	0	5	5
Gjermani	15	55	70
Irlandë	0	25	25
Greqi	5	405	410
Spanjë	0	5	5
Francë	40	425	465
Itali	65	25	85
Qipro	0	5	5
Luksemburg	0	15	15
Holandë	0	25	25
Austri	5	10	15
Finlandë	0	5	5
Suedi	20	165	185
Mbretëri e Bashkuar	75	185	260
Norvegji	0	35	35
Zvicër	0	25	25

Burimi: Të dhëna (të rrumbullakosura) mujore për vendimet e shkallës së parë për aplikimet sipas nën-shtetësisë, moshës dhe gjinisë

Niveli i pranueshmërisë së kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në vendet e BE-së paraqitet i ulët gjatë vitit 2011. E njëjta tendencë vërehet edhe në shkallë vendi: Belgjikë (415 vendime të hedhura poshtë nga 445), Greqi (405 vendime të hedhura poshtë nga 410) dhe Francë (425 vendime të hedhura poshtë nga 465). Seksioni në vazhdim sjell perspektivën e azilkërkuesve shqiptarë mbi sa më sipër.


PERSPEKTIVA NGA AZILKËRKUESIT SHQIPTARË NË BELGJIKË, FRANCË DHE GREQI

Intervista gjysmë të strukturuar janë zhvilluar me azilkërkuesit shqiptarë në pritje të vendimit final mbi aplikimin e tyre në Belgjikë, Francë dhe Greqi me qëllim mbledhjen e të dhënave mbi profilin e tyre dhe mbi përvojat si azilkërkues. Pyetësi që u përdor për këtë qëllim përmbante dy seksione.

Profili i përgjithshëm i azilkërkuesve shqiptarë


Seksioni i parë i pyetësit synon mbledhjen e informacionit për vendin e aplikimit për azil, gjininë, moshën, nivelin e arsimit dhe rajonin e origjinës.

Grafiku 2: Përfaqësimi gjinor i të gjithë kampionit



Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012


Grafiku 3: Përfaqësimi moshor i të gjithë kampionit



Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012


Përfaqësimi moshor i të gjithë kampionit tregon se shumica e të intervistuarve i përkasin grup-moshave 26-35 vjeç (47%) dhe 36-45 vjeç (22%) të cilat përbëjnë pjesën më aktive të popullsisë shqiptare.¹⁸ Sipas vendeve, Franca përfaqëson kampionin më të ri me 70% të të intervistuarve që iu përkasin grupmoshave më pak se 35 vjeç e ndjekur nga Greqia ku 53% e të intervistuarve janë më pak se 35 vjeç. Në Belgjikë 58% e të intervistuarve janë mbi 35 vjeç.

Grafiku 4: Të intervistuarit nga zonat urbane dhe rurale



Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

Grafiku 5: Niveli arsimit për të gjithë kampionin



Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

18. Në vitin 1995 emigrantët shqiptarë përfaqësonin 26% të forcës së punës së Shqipërisë, në vitin 1998 71% e emigrantëve shqiptarë ishin 20-31 vjeç dhe në vitin 2009 mbi 35% e forcës së punës të vendit kishte migruar. Gedeshi, I and De Zwager, N. 'Effects of Global Crisis on Migration and Remittances in Albania' In: The World Bank, 'Migration and Remittances during the Global Crisis and beyond' qershor 2012, fq. 239


Për sa i përket vendbanimit përpara migrimit, në përgjithësi shumica e të intervistuarve (75%) jetonin në zonat urbane. E njëjta tendencë vërehet edhe në secilin vend: në Francë 60% e të intervistuarve vijnë nga zonat urbane, në Greqi kjo shifër i korrespondon 50% të tyre dhe në Belgjikë 42% e të intervistuarve kanë jetuar në zona urbane përpara se të migronin.

Për sa i përket nivelit arsimor të të gjithë kampionit, vërehet se 43% e të intervistuarve kanë përfunduar shkollën e mesme, 22% kanë mbaruar shkollën fillore dhe 16% kanë diplomë universitare. Rreth 13% e të intervistuarve kanë ndjekur studimet pasuniversitare dhe 6% e tyre janë të paarsimuar. Sipas vendeve, në Greqi 39% e të intervistuarve kanë përfunduar shkollën e mesme, 20% universitetin dhe 27% e tyre kanë ndjekur studime pasuniversitare. Të intervistuarit në Belgjikë paraqesin nivel të kënaqshëm arsimi, ku 57% kanë përfunduar shkollën e mesme dhe 14% kanë arsim universitar. Të intervistuarit në Francë janë të tretët për sa i përket arsimit (40% kanë përfunduar shkollën e mesme).

Përvoja si azilkërkues

Për të pasur një panoramë më të qartë të profilit dhe përvojës të kërkimit të azilit, u zhvilluan intervista gjysmë të strukturuar në Belgjikë, Francë dhe Greqi me azilkërkues shqiptarë të cilët kanë aplikuar për azil në këto vende dhe janë aktualisht në pritje të vendimeve finale mbi aplikimet e tyre. Pyetësi i përdorur për këtë qëllim përmban dy seksione.

Grafiku 6: Arsyet që kanë ndikuar për të kërkuar azil në vendin përkatës: i gjithë kampioni



Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

Duke vërejtur të gjithë kampionin, faktorët që ndikojnë më së shumti vendimin për të kërkuar azil në një vend të caktuar (faktorët tërheqës) janë: 'procedurat për azil kërkojnë më pak kohë' (15%), 'kriteret e vendosura prej autoriteteve përmbushen më lehtë', (13%) dhe 'është më e lehtë të hysh në vendin ku kam aplikuar për azil' (13%). Grupi tjetër përbëhet nga arsye si shanset për marrjen e azilit janë më të mëdha (12%) vendi pritës garanton kushte më të mira për azilkërkuesit (11%) dhe kam anëtarë të familjes që kanë emigruar më parë në këtë vend (10%). Arsyet tërheqëse që janë përmendur më pak përfshijnë 'vendi ofron më shumë përkrahje sociale për emigrantët (9%), 'kam emigruar më parë në këtë vend (9%) dhe 'e kam vizituar më parë këtë vend' (8%).


Megjithatë, faktorët tërheqës ndryshojnë sipas vendeve. Në Belgjikë faktorët shtytës që përmenden më shumë janë: procedurat e azilit kërkojnë më pak kohë dhe 'vendi garanton kushte më të mira pritjeje për azilkërkuesit' (ku secili faktor ka 16%) të ndjekur prej 'kriteret e vendosura prej autoriteteve përmbushen më lehtë' (15%), 'vendi pritës garanton më shumë përkrahje sociale për emigrantët' (14%) dhe 'është më e lehtë për të hyrë në vendin ku kam aplikuar' (14%). Në Francë faktorët tërheqës më të përmendur përfshijnë 'kam emigruar më parë në këtë vend' (16%), 'procedurat për azil kërkojnë më pak kohë' (14%), 'kriteret e vendosura nga autoritetet përmbushen më lehtë' dhe shanset për marrjen e azilit janë më të mëdha (13% secili faktor)

Tabela 4: Arsyet që kanë ndikuar për të kërkuar azil në vendin përkatës (sipas vendeve)

Arsyet	Belgjikë	Francë	Greqi
Procedurat e azilit kërkojnë më pak kohë	16 %	14 %	14 %
Kriteret e vendosura nga autoritetet përmbushen më lehtë	15 %	13 %	13 %
Shanset për marrjen e azilit janë më të mëdha	10 %	11 %	13 %
Vendi garanton kushte më të mira pritjeje për ata që aplikojnë për azil	16 %	11 %	9 %
Vendi ofron më shumë përkrahje sociale për emigrantët	14 %	6 %	10 %
Është më e lehtë të hysh në vendin ku kam aplikuar	14 %	9 %	16 %
Kam anëtarë të familjes të emigruar më parë në këtë vend	5 %	8 %	13 %
E kam vizituar më parë këtë vend	5 %	12 %	6 %
Kam emigruar më parë në këtë vend	5 %	16 %	6 %


Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

Grafiku 7: A jeni informuar paraprakisht për vendin që keni aplikuar për azil



Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

Grafiku 8: Burimet e informacionit përpara migrimi




Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

Pyetja tjetër synonte të mësonte nga të intervistuarit nëse ata kishin marrë ose jo informacion për vendin që kishin aplikuar për azil përpara migrimit. Në total 31% e të intervistuarve thanë se kishin marrë informacion dhe 69% e tyre theksuan se nuk kishin marrë informacion paraprak mbi vendin ku kishin kërkuar azil. Për sa i përket kampioneve të vendeve, në Belgjikë asnjë nga të pyeturit nuk kishte marrë informacion paraprak. Në Greqi 47% e të intervistuarve ishin të informuar çka nuk është e papritur duke pasur parasysh përvojën 20 vjeçare të emigrantëve shqiptarë atje. Në Francë 30% e të intervistuarve kishin informacion paraprak.

Të intervistuarit që thanë se kishin informacion paraprak u pyetën mbi burimet e këtij informacioni. 42% e tyre theksuan si burim informacioni

familjarë/të afërm që kanë aplikuar më parë në atë vend; 17% theksojnë TV/ radio të huaja dhe 18% janë informuar nëpërmjet internetit. Gazetat shqiptare dhe ato të huaja dhe TV/radio shqiptare përmenden secila nga 8% e të anketuarve.

Grafiku 9: Arsyet që i paraqiten autoriteteve kur aplikohet për azil: i gjithë kampioni



Burimi: Pyetësor me azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

Tabela 5: Arsyet që i paraqiten autoriteteve kur aplikohet për azil sipas vendeve

Arsyet	Belgjikë	Francë	Greqi
Punësim			60 %
Probleme shëndetësore			13 %
Bashkim familjar			27 %
Kërcënimi për jetën	14 %	40 %	
Gjakmarrje	43 %	40 %	
Arsyet politike	14 %	20 %	
Konflikte pronësie	29 %		

Burimi: Pyetësor me Azilkërkuesit shqiptarë në vendet e BE-së, IDM, 2012

Duke iu referuar të gjithë kampionit, shumica e të anketuarve theksojnë punësimin (28%), gjakmarrjen (22%) dhe kërcënimin për jetën (16%) si arsye të paraqitura përpara autoriteteve kur aplikojnë për azil. 13% e të anketuarve kanë aplikuar për azil për bashkim familjar dhe 9% e tyre kanë aplikuar bazuar tek arsyet politike.¹⁹ Arsyet më pak të përmendura janë probleme

19. Pasiguria politike është përdorur si arsye prej emigrantëve shqiptarë kryesisht gjatë viteve 1997-98 me krizën e firmave piramidale që shkaktoi rënien e shtetit në Shqipëri dhe gjatë vitit 1999 me

shëndetësore dhe konflikte për pronësinë²⁰ (6% secili).

Edhe pse me një diferencë të vogël, të dhënat nga kampioni i përgjithshëm tregojnë se arsyt kryesore që qëndrojnë pas kërkesave për azil lidhen me kushtet ekonomike dhe sociale të vendit. Edhe një studim i European Training Foundation²¹ thekson se 2/3 e të intervistuarve të tij duan të migrojnë për arsye ekonomike.

Për sa i përket vendeve të ndryshme, në Greqi mbizotërojnë arsyt ekonomike (60%). Në Belgjikë shumica e të intervistuarve kanë aplikuar për azil bazuar në gjakmarrje (43%), konflikte pronësie (29%), arsye politike (14%) dhe kërcënim për jetën (14%). Në Francë 40% e të intervistuarve kanë aplikuar për azil për shkaqe gjakmarrjeje, 40% kanë aplikuar bazuar në kërcënim për jetën, ndërsa 20% i mbetur kanë aplikuar për arsye politike.

Të dhënat nga pyetësi theksojnë se në Francë dhe Belgjikë faktorë si kërcënim për jetën, gjakmarrja dhe pasiguria politike mbizotërojnë kundrejt arsyeve ekonomike dhe familjare ndërsa në Greqi vërehet e kundërta. Sipas pyetësorit tonë shqiptarët që aplikojnë për azil në Belgjikë dhe Francë më së shumti vijnë nga veriu i Shqipërisë, një zonë me burime të pakta ekonomike dhe ku fenomeni i gjakmarrjes përbën shqetësim serioz.

Për të trajtuar në mënyrën e duhur arsyt që kushtëzojnë kërkesat për azil nevojitet që të zhvillohet një kuadër solid politikash që ta trajtojë sfidat e menaxhimit të migrimit dhe ri-integrimit. Duke pasur parasysh këtë arsyetim, kapitulli i mëposhtëm analizon Strategjinë për Ri-integrimin e Shtetasve shqiptarë të ri-kthyer dhe planin e saj të veprimit.

konfliktin në Kosovë. Pas vitit 2000 me përmirësimin e situatës sociale dhe politike kjo arsye është përdorur më pak. Megjithatë, ajo mbetet një arsye që përdoret gjerësisht prej azilkërkueseve, pasi paraqitja e arsyeve jo-ekonomike mundëson më tepër shanse për të përfituar azil.

20. Konfliktet për pronësi u rishfaqën gjatë viteve 1991 në vijim të lëvizjeve demografike masive dhe të pakontrolluara brenda Shqipërisë nga zonat malore drejt atyre bregdetare dhe fushore. Lëvizjet demografike të pakontrolluara brenda vendit, mungesa e kuadrit ligjor për pronësinë dhe institucionet e dobëta kanë ndikuar që mosmarrëveshjet për tokën shpesh të përkeqësohen dhe të kalojnë në dhunë.

21. European Training Foundation, 'The Contribution of Human Resources Development to Migration Policy in Albania' 2007, fq. 28

STRATEGJIA PËR RI-INTEGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË TË RIKTHYER DHE PLANI I VEPRIMIT

Strategjia

Strategjia për Ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer 2010-2015 dhe plani i veprimit të saj u aprovuan në qershor të vitit 2010. Strategjia trajton të gjithë shtetasit shqiptarë të rikthyer (pavarësisht formës) por më së shumti trajton shtetasit shqiptarë të rikthyer në kuadër të marrëveshjes së ripranimit me BE-në. Edhe pse është vlerësuar si një mjet pozitiv për menaxhimin e emigrimit dhe trajtimin e sfidave të ri-integrimit prej Komisionit Evropian (KE)²² ky vlerësim i referohet më së shumti zbatimit të marrëveshjeve të ripranimit. Për më tepër, strategjia është hartuar brenda një kohe mjaft të shkurtër dhe si rrjedhojë trajton pjesërisht çështjet që lidhen me menaxhimin e emigrantëve të rikthyer dhe ri-integrimin e tyre.

Strategjia përmban katër kapituj. Kapitulli i parë përshkruan historikun e rikthimit të emigrantëve dhe masat e ndërmarra përpara kësaj strategjie në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Migracionin. Kapitulli i dytë thekson vizionin e strategjisë dhe parashtron objektivat dhe masat që duhen zbatuar. Kapitulli i tretë përcakton modalitetet për monitorimin dhe llogaridhënien, ndërsa kapitulli i katërt përfshin planin e veprimit.²³

Analizë e planit të veprimit

Plani i Veprimit përfshin 3 prioritete, 10 objektiva specifike dhe 42 masa. (Për analizë të detajuar të masave shih aneksin.) Edhe pse niveli i zbatimit të plan-veprimit raportohet si i lartë (86%) gjatë viti 2012, ekzistojnë një sërë çështjesh të cilat duhen trajtuar për të pasur një kuadër masash, të cilat gjenerojnë në terma afatgjatë menaxhim të qëndrueshëm të migrimit dhe ri-integrimin e shtetasve të rikthyer.

22. European Commission 'Albania 2011 Progress Report: Enlargement Strategy and Main Changes.', fq.55

23. Republika e Shqipërisë, 'Strategjia për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer 2010-2015.' qershor 2010, fq. 20



- **Kuadri i përgjithshëm ligjor për mbështetjen e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer** është miratuar. Megjithatë, vërehet se nuk kryhet vlerësimi i ndikimit që ka në praktikë ky legjisllacion.
- **Kuadri institucional që mbështet ri-integrimin e shtetasve të rikthyer nëpërmjet ngritjes së Sporteleve të Migracionit (SM)** është vendosur dhe funksionon në të gjithë Zyrat Rajonale të Punësimit. Megjithatë, regjistrimi i shtetasve të rikthyer pranë këtyre strukturave mbetet në nivele të ulëta krahasuar me numrin e përgjithshëm të tyre. Kjo tregon se për të forcuar besimin tek këto struktura nevojitet forcimi i lidhjeve ndërmjet autoriteteve publike, komunitetit të biznesit dhe aktorëve të shoqërisë civile që merren me këto çështje.²⁴ Për më tepër SM duhet të ofrojë shërbime konkrete që shkojnë përtej informimit për të rritur efikasitetin e tyre dhe për të shërbyer si struktura të përshtatshme për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer.²⁵
- **Mbështetja e ri-integrimit të shtetasve të rikthyer në jetën ekonomike dhe sociale të vendit nuk përfshin masa të përshtatshme për trajtimin e nevojave.** Masat informative mbizotërojnë mbi ndërhyrjet konkrete (nga 24 masa në prioritetin C 11 synojnë informim). Edhe pse informimi mund të ketë qenë i rëndësishëm gjatë fazave të para të procesit, këto masa duhen reduktuar dhe zëvendësuar me ndërhyrje konkrete.
- **Ri-integrimi i shtetasve shqiptarë të rikthyer në programe për nxitjen e punësimit dhe në formimin profesional** synon kryesisht integrimin e shtetasve të rikthyer në programet për nxitjen e punësimit dhe për trajnim profesional të cilët përfshijnë edhe pjesë të tjera të popullsisë. Gjithashtu, masat në fjalë nuk përfshijnë ndonjë program specifik që të trajtojë nevojat e shtetasve të rikthyer. Për më tepër numri i shtetasve të rikthyer që marrin pjesë në këto programe paraqitet në nivele të ulëta.
- **Ri-integrimi i shtetasve shqiptarë të rikthyer në sistemin arsimor** përfshin një numër të madh masash me karakter normativ dhe nuk paraqet ndonjë ndërhyrje konkrete.
- **Për ri-integrimin e të rikthyerve në skemat e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve psiko-sociale,** masat kryesisht trajtojnë integrimin e shtetasve të rikthyer në skemat ekzistuese dhe nuk synojnë ndonjë ndërhyrje specifike për ta. Gjithashtu, numri i shtetasve të rikthyer të integruar në skemat e sigurimeve shoqërore dhe

24. Report by the Special Rapporteur on the human rights of migrants, François Crépeau, on his mission to Albania, 13 December 2011

25. Po aty. Fq. 13

atyre shëndetësore mbetet i ulët.

- **Trajtimi i nevojave për strehim të shtetasve të rikthyer dhe përfshirja e tyre në skemat për zhvillimin bujqësor** përfshinë kryesisht masa me karakter informativ dhe ndryshime legjislativ të cilat nuk mundësojnë ndërhyrje konkrete. Po ashtu, ndikimi i masave që lidhen me përfshirjen e shtetasve të rikthyer në skemat për investime në bujqësi është i vogël, pasi raportohet se gjatë 2011 asnjë shtetas shqiptar i rikthyer nuk ka aplikuar për skema të tilla pavarësisht kriterëve lehtësues të aplikuar për ta.
- **Për sa i përket ri-integrimit nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe organizatat** ndërkombëtare ai duhet forcuar më tej sidomos në nivel vendor.



REKOMANDIME

Nga analiza e tendencave të aplikimeve për azil të shtetasve shqiptarë drejt BE-së përgjatë periudhës së liberalizimit të vizave vërehet se shtimi më i madh i tyre ka ndodhur duke filluar që prej gjysmës së dytë të vitit 2012 e në vazhdim. Edhe pse nuk kanë pasur të njëjtin intensitet si aplikimet për azil nga Serbia dhe Maqedonia, aplikimet nga shtetasit shqiptarë drejt vendeve të BE-së mbeten shqetësuese. Për sa i përket arsyeve kryesore që qëndrojnë pas kërkesave për azil të dhënat nga pyetësorët me azilkërkues ritheksuan se shqetësimet e brendshme ekonomike dhe shoqërore mbeten faktorët shtytës kryesorë që nxisin emigrimin e paligjshëm dhe kërkesat për azil. Lidhur me gjakmarrjen, ndërsa ajo nuk mund të hidhet tërësisht poshtë si arsye për të kërkuar azil, mund të theksojmë se përgjatë periudhës 2011-2012 ajo është keqpërdorur dhe mediatizuar gjerësisht.

Duke qenë se faktorët kryesorë që shtojnë shqiptarët për të emigruar ilegalisht dhe për të kërkuar azil lidhen kryesisht me shqetësimet e brendshme ekonomike dhe sociale, për të pasur një menaxhim efikas të emigracionit dhe një kuadër funksional për ri-integrimin në terma afatgjatë nevojitet të konsiderohen rekomandimet e poshtëpërmendura:

- Për hartimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Rikthyer nevojitet kryerja e vlerësimeve dhe konsultimeve në bashkëpunim me aktorë të pavarur nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me migrimin.
- Masat me karakter informativ duhen reduktuar për t'ju lënë vendin ndërhyrjeve konkrete që mbështetin ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer, vlerësimit të nevojave të tyre në fusha të ndryshme dhe ri-integrimit të tyre të qëndrueshëm.
- Kuadri ligjor që mbështet ri-integrimin është tashmë i vendosur duhet të vlerësohet në terma konkretë ndikimi i tij në praktikë.
- Numri i shtetasve të rikthyer që regjistrohen në Sportelet e Migracionit mbetet i ulët. Prandaj nevojiten përpjekje që shkojnë përtej informimit për të bërë që këto struktura të jenë funksionale.

- Për të trajtuar më mirë ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer në jetën ekonomike të vendit nevojitet hartimi i programeve për nxitjen e punësimit dhe formimin profesional që përputhen me nevojat e tyre në mënyrë që të arrihet ri-integrimi i tyre i qëndrueshëm në jetën ekonomike të vendit.
- Nevojitet ndërmarrja e ndërhyrjeve konkrete që të trajtojnë problemet e shtetasve të rikthyer me strehimin dhe për ri-integrimin e tyre në sistemin arsimor.



SHTOJCA 1: ANALIZË E DETAJUAR E PLAN-VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR RI-INTEGRIMIN E SHTETASVE SHQIPTARË TË RIKTHYER.

Prioriteti A: Përmirësimi i kuadrit ligjor në mbështetje të ri-integrimit

*Objektivi 1.1: Përmirësimi i kuadrit ligjor në mbështetje të ri-integrimit*²⁶

- Masa 1: Ndryshime në Ligjin 9668/2006 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi" Neni 2 (14) për përkufizimin e emigrantit të rikthyer, Neni 13 mbi " statusin e emigrantit" dhe Neni 8 (1) "E drejta për të përfituar nga shërbimet shtetërore."
- Masa 2: Ndryshimi i Urdhrit Nr. 1722, datë 18.09.2007 "Për formën, përmbajtjen e dokumentit dhe procedurën e përfitimit të statusit të emigrantit dhe procedurën e përfitimit të statusit."
- Masa 3: Ndryshim i Urdhrit të Ministrit të Punës Nr 2086, datë 13.11.2007 "Për formën dhe përmbajtjen e "Regjistrit për emigrantët." Dhe procedurat e regjistrimit bazuar në nenin 104 pika 4 të Kushtetutës dhe nenin 12 të Ligjit 9668/2006 për krijimin e një banke të dhënash për ruajtjen e të dhënave të shtetasve shqiptarë të rikthyer dhe regjistruar pranë Sporteve të Migracionit.
- Masa 4: Përfshirja në kategorinë e shtetasve shqiptarë të kthyer me probleme ekonomike, në grupet e veçanta të të papunëve që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit. Më konkretisht: Ndryshimi në VKM Nr. 632 datë 18.9.2003 "Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra"; Ndryshimi në VKM nr 48 datë 16.1.2008 "Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve në vështirësi."
- Masa 5: Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve përkatëse në Urdhrin Nr. 782 datë 4.4.2006 të Ministrit të Punës "Për tarifatat e sistemit të formimit profesional" për të mundësuar ofrimin e trajnimeve falas në drejtoritë rajonale të formimit profesional publik të shtetasve të rikthyer me prob-

26. Objektivat nuk janë ndarë sipas numrave në plani e veprimit dhe numërimi i tyre është bërë vetëm për të lehtësuar këtë analizë.

leme ekonomikë.

- Masa 6: Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin Nr. 9232 datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" për të mundësuar sigurimin e zgjidhjeve afatgjata të problemit të strehimit për shtetasit shqiptarë të kthyer të pastrehë nëpërmjet programeve sociale të strehimit. Ndryshimet në VKM Nr 53/2005 mbi dokumentacionin që duhet të plotësojnë emigrantët e kthyer për të aplikuar për strehim.
- Masa 7: Përfshirja në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për fillimin e vitit të ri shkollor." e modaliteteve dhe veprimeve për tu kryer në rastet e fëmijëve të shtetasve shqiptarë të rikthyer për regjistrimin për herë të parë në sistemin arsimor të fëmijëve të lindur jashtë vendit, vazhdimin e studimeve të nisura jashtë vendit, ekuivalentimi i dëftesave dhe diplomave.
- Masa 8: Ndryshimi i VKM vjetor për skemat mbështetëse.
- Masa 9: Ndryshimi i udhëzimit të përbashkët vjetor të MBUK dhe MF.

Analizë²⁷

Masa 1 është zbatuar nëpërmjet miratimit të Ligjit Nr. 10389, datë 18.12.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9668 "Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi". Me anë të këtij ligji shtetasit shqiptarë të rikthyer janë përfshirë në përkufizimin e emigrantit të rikthyer, ata mund të marrin statusin e emigrantit si dhe të përfitojnë nga shërbimet përkatëse. Me gjithë ndryshimet e bëra, kjo masë nuk ofron ndonjë shembull konkret se si ndikojnë në ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer ndryshimet e kryera legjislative.

Për zbatimin e masës 2 është miratuar një urdhër i Ministrit të Punës që synon përfshirjen e shtetasve të rikthyer në kategorinë që përfiton nga marrja e statusit të emigrantit. Edhe për këtë masë nuk ofrohet ndonjë shembull konkret ndikimi për ri-integrimin e shtetasve të rikthyer.

Masa 3 është zbatuar nëpërmjet hartimit të një urdhri të Ministrit të Punës që synon përfshirjen e shtetasve shqiptarë të rikthyer në regjistrin e emigrantit dhe krijimin e një baze të dhënash me të dhëna të shtetasve të rikthyer në sportelet e migracionit. Kjo masë është e dobishme, pasi krijimi i një baze të dhënash është në parim hapi i parë për vlerësimin dhe trajtimin

27. Sekretariati Teknik, 'Raporti i Monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të ri-kthyer.' Dhjetor 2011, fq.12-17



e nevojave të tyre.

Për zbatimin e masës 4 janë kryer ndryshimet përkatëse në aktet ligjore për përfshirjen e shtetasve shqiptarë të rikthyer në programet për nxitjen e punësimit që specifikon masa.

Masa 5 është zbatuar nëpërmjet një urdhri të Ministrit të Punës i cili synon përfshirjen e emigrantëve të rikthyer në kategorinë e përfituesve nga trajnimet profesionale pa pagesë.

Masat 4 dhe 5 synojnë përfshirjen e shtetasve shqiptarë të rikthyer në programet ekzistues për nxitjen e punësimit dhe për trajnim profesional pa pagesë dhe nuk synojnë ndonjë program të ri sipas nevojave të këtyre shtetasve. Për më tepër, nuk ofrohet ndonjë evidencë për ndikimin konkret të këtyre masave në përfshirjen e shtetasve të rikthyer në programet për nxitjen e punësimit dhe në programet e trajnimit profesional pa pagesë.

Masa 6 raportohet si në proces. Megjithatë, përtej këtij fakti kjo masë thjesht merret me ndryshime ligjore dhe nuk specifikon se cili do të jetë ndikimi i tyre konkret për trajtimin e nevojave për strehim të shtetasve shqiptarë të rikthyer.

Masa 7 raportohet si e zbatuar për të tre komponentët e saj. Brenda prioritetit A kjo është e vetmja masë, e cila jep të dhëna konkrete për numrin e fëmijëve të shtetasve të rikthyer që janë regjistruar në sistemin arsimor dhe për diplomat e njohura duke matur ndikimin e saj në mënyrë konkrete.

Në lidhje me masat 8 dhe 9, edhe pse janë miratuar aktet ligjore përkatëse, vërehet se ato kanë ndikim të kufizuar në ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer. Për më tepër vetë raporti thekson se deri në fund të vitit 2011 asnjë shtetas shqiptar i rikthyer nuk ka përfituar nga pjesëmarrja në skemat për mbështetjen e zhvillimit të bujqësisë.

Prioriteti B: Sigurimi i strukturave efektive dhe racionale për institucionet publike për të garantuar mbështetjen e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer.

Objektivi 2.1: Krijimi dhe përmirësimi i kuadrit institucional për mbështetjen e shtetasve shqiptarë të kthyer.

- Masa 10: Ngritja e Sporteleve të Migracionit (SM) në 22 Zyra Vendore të Punësimit (ZVP)
- Masa 11: Shpërndarja e informacionit për ri-integrimin e të rikthyerve në PKK dhe gjatë intervistimit të personave të ripranuar nga vendet e tjera.

- Masa 12: Përmirësimi i bashkëpunimit me autoritetet shtetërore përgjegjëse që përfshihen në këtë strategji për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm. Vendosja e pikave të kontaktit me çdo autoritet shtetëror përgjegjës, organizimi i takimeve periodike, shkëmbimi i informacionit periodik për rastet e kthimeve.

Analizë

Raporti i monitorimit thekson se në zbatim të masës 10 SM janë ngritur dhe funksionojnë pranë të gjithë ZVP që prej qershorit 2010 dhe se deri në dhjetor 2011 2715 shtetas të rikthyer janë ndihmuar me shërbime informuese dhe referuese. Por vlen të theksohet se numri i shtetasve të regjistruar pranë SM është dukshëm më i ulët sesa numri i shtetasve të rikthyer që janë regjistruar në PKK përgjatë periudhës dhjetor 2010-prill 2012 (7738).²⁸

Për masën 11 raporti jep detaje mbi numrin e posterave, broshurave dhe materialeve informues mbi SM dhe shërbimet që ato ofrojnë për ri-integrimin që janë shpërndarë në PKK. Përtej këtij fakti, kjo masë (sikundër edhe masat 18 dhe 19 më poshtë) është me karakter informues dhe nuk synon ndërhyrje konkrete që të shkojnë përtej informimit. Masat e kësaj natyre duhen pakësuar në maksimum e të zëvendësohen me ndërhyrje konkrete.

Për zbatimin e masës 12 theksohet se janë vendosur në të gjithë institucionet përgjegjës personat e kontaktit për shkëmbimin e informacionit dhe se gjatë periudhës 2010-2011 janë mbajtur katër takime me synim shkëmbimin e informacionit për monitorimin dhe zbatimin e planit të veprimit. Edhe kjo masë synon thjesht shkëmbim informacioni dhe rithekson faktin se për forcimin e kuadrit institucional që trajton ri-integrimin nevojiten ndërhyrje konkrete që shkojnë përtej shkëmbimit të thjeshtë të informacionit.

Objektivi 2.2: Forcimi i kapaciteteve të strukturave që merren me ri-integrimin e të kthyerve në Shqipëri.

- Masa 13: Trajnimi i personelit të SM për intervistimin, identifikimin e nevojave, dhënien e informacionit dhe referimit për shtetasit shqiptarë të kthyer.
- Masa 14: Plotësimi i kushteve në PKK të miratuara për ri-pranimin e shtetasve që kthehen nga policitë e vendeve të tjera për akomodimin dhe intervistimin e tyre.
- Masa 15: Sigurimi i transportit të të kthyerve nga PKK deri në qendrat më të afërta urbane si edhe për grupet e cënueshme deri në qendrat më

²⁸. Të dhëna mundësuar nga Policia e Kufirit dhe Migracionit



të afërta të banimit.

- Masa 16: Sigurimi i nevojave për ushqim, ujë dhe medikamente për të rikthyerit në PKK.
- Masa 17: Zgjerimi i veprimtarisë e problematikave të trajtuara në seminarin e përvitshëm për mësuesit duke synuar rritjen e aftësisë në përgjigje të një plani afatgjatë për ri-integrimin e personave të ripranuar.

Analizë

Për zbatimin e masës 13 janë organizuar dy trajnime me stafin e SM për përmirësimin e kapaciteteve për të ofruar shërbime, janë organizuar 3 trajnime dhe një seminar për "Politikat e Rikthimit dhe Riakomodimit" në 16 rrethe si dhe është mundësuar një kurs 4 ditor për stafin e SM-ve. Kjo masë është e përshtatshme për përmbushjen e objektivit ku është vendosur dhe është po aq e dobishme për rritjen e kapaciteteve të personelit të SM-ve.

Për sa i përket masës 14, 10 PKK dhe 17 Stacione të Policisë Kufitare janë pajisur me hapësirat e nevojshme dhe logjistikën përkatëse për pritjen dhe intervistimin e shtetasve të rikthyer. Pavarësisht kësaj i dërguari special i OKB-së ka shprehur shqetësim lidhur me cilësinë e mjediseve që përdoren për akomodimin e shtetasve të rikthyer.²⁹

Lidhur me masën 15 raport përmend kontraktimin e tre kompanive të transportit për transportimin e shtetasve të rikthyer nga 3 PKK (Kapshticë, Kakavijë dhe Oafë Botë) si dhe se transporti nga pikat e tjera bëhet nëpërmjet mjeteve të PKM-së.

Për masën 16 theksohet se qytetarët e rikthyer që kanë nevojë për ushqim, ujë dhe medikamente janë të pakët në numër.

Masat 14 dhe 16 kanë karakter të përgjithshëm dhe nuk trajtojnë në mënyrë specifike shtetasit shqiptarë të rikthyer por mund të jenë të aplikueshme edhe për kategori të tjera emigrantësh të rikthyer. Së dyti ato nuk trajtojnë ndonjë forcim të kapaciteteve institucionale por thjesht ofrojnë shërbime.

Për masën 17 raportohet se programet për gjuhën dhe kulturën shqipe janë hartuar që në vitin 2010 dhe se seminarët përkatës me mësuesit janë organizuar në qershor 2010 dhe në gusht 2011. Kjo masë nuk jep asnjë lloj evidence mbi ndikimin e kurrikulave që përfshin ajo tek shtetasit e rikthyer.

29. 'Report by the Special Rapporteur on the human rights of migrants, François Crépeau, on his mission to Albania, 13 December 2011.', fq.17.

Prioriteti C: Integrimi i shtetasve shqiptarë të rikthyer në jetën ekonomike dhe sociale të vendit nëpërmjet informacionit, referimit dhe shërbimeve të drejtpërdrejta.

Objektivi 3.1: Mbështetja e ri-integrimit ekonomik të shtetasve të rikthyer përmes informacionit.

- Masa 18: Përgatitja dhe prodhimi i fletëpalosjeve me informacion orientues për të kthyerit lidhur me SM dhe kontaktet e tyre për t'u shpërndarë tek shtetasit e rikthyer në PKK.
- Masa 19: Përgatitje posterash për tu vendosur në PKK.
- Masa 21: Botimi i fletëpalosjeve me informacion: "Si të hapësh biznes në Shqipëri"; "Ku të investosh në Shqipëri", "Informacioni për përkrahjen sociale"; "Informacion për skemat e sigurimeve shoqërore"; informacion për aksesin në sistemin shëndetësor, kushtet dhe kriteret e përfitimit, dokumentacioni dhe procedurat".
- Masa 22: Shpërndarje informacioni mbi mundësitë e kreditimit për shtetasit shqiptarë të kthyer në kuadër të Programit të Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme Itali-Shqipëri.
- Masa 23: Shpërndarje e informacionit të parashikuar në planin e veprim nëpër përfaqësitë e Shqipërisë të akredituara jashtë vendit.
- Masa 24: Pasqyrimi në faqet e internetit mpcs.gov.al dhe migrantinfo.gov.al i informacionit të hartuar për mbështetjen e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer.

Analizë

Për zbatimin e masave 18 dhe 19 raporti jep detaje mbi broshurat dhe posterat informues për SM-të që janë përgatitur dhe shpërndarë. Këto dy masa mund të ishin përmbledhur edhe në një masë të vetme duke qenë se kanë të njëjtin qëllim.

Edhe për zbatimin e masave 21 dhe 22 raporti i monitorimit jep detaje mbi numrin e broshurave me informacioni përkatës që janë shpërndarë. Për këto dy masa duhet theksuar se informacioni i ofruar jo gjithmonë trajton në mënyrë specifike shtetasit shqiptarë të rikthyer. Për më tepër, shumica e shtetasve shqiptarë të rikthyer në kuadrin e marrëveshjeve të ripranimit nuk kanë grumbulluar gjatë periudhës së emigracionit kapital human, social dhe financiar që nevojitet për hapjen e bizneseve në Shqipëri. Kësisoj informacioni i ofruar për SME-të dhe për hapjen e një biznesi në Shqipëri mund të jetë më pak i nevojshëm për këtë kategori emigrantësh të rikthyer kraha-



suar me kategori të tjera shtetasish që rikthehen nga emigracioni, pasi kanë përmbushur me sukses qëllimin për të cilin kanë emigruar.

Për masën 23 sërish jepen detaje mbi broshura me informacion të shpërndara në misionet jashtë vendit si dhe mbi trajnime të stafit konsullor për trajtimin e problematikës së shtetasve të rikthyer. Ndërkohë që masa bën fjalë për shpërndarje informacioni raportohen edhe trajnime të personelit konsullor, të cilët nuk synohen nga masa në fjalë.

Për masën 24 mund të thuhet se ndërsa të dy faqet e internetit janë funksionale ato shpesh kanë probleme në seksione të caktuara dhe informacioni në to ka nevojë të përditësohet.

Objektivi 3.2: Mbështetja e ri-integrimit ekonomik të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes programeve të nxitjes ekonomike.

- Masa 25: Përfshirja e emigrantëve të rikthyer me probleme ekonomike që plotësojnë kriteret e përcaktuara në programet e nxitjes së punësimit. Konkretisht: Programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra; programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë me vështirësi ekonomike, programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë dhe programi i praktikave profesionale.
- Masa 26: Identifikimi i nevojave ekzistuese për formimin profesional të shtetasve shqiptarë të rikthyer.

Analizë

Për zbatimin e masës 25 raportohet se gjatë vitit 2011, 2278 shtetas të rikthyer u regjistruan si punëkërkues të papunë që mund të përfshihen në programet për nxitjen e punësimit si dhe jepen detaje mbi numrat e të rikthyerve që mund të përfshihen në këto programe. Masa synon përfshirjen e shtetasve shqiptarë të rikthyer në problemet aktuale për nxitjen e punësimit dhe nuk përmban asnjë ndërhyrje të re për trajtimin e nevojave të tyre në këtë fushë.

Lidhur me masën 26 theksohet se nevojat për trajnim profesional të shtetasve të rikthyer janë identifikuar dhe se janë hartuar kurrikula për trajnime në riparimin e paneleve diellorë, berber/estetikë dhe rrobaqepës. Në raport nuk specifikohet se si janë vlerësuar nevojat e shtetasve të rikthyer.

Objektivi 3.3: Mbështetja e ri-integrimit ekonomik të shtetasve shqiptarë të rikthyer përmes përfshirjes në kurset e formimit profesional.

- Masa 27: Pjesëmarrja e emigrantëve të kthyer me probleme ekonomike që plotësojnë kriteret e përcaktuar në kurse publik të formimit profesional me tarifa falas. Përshtatje e kurrikulave ekzistuese.
- Masa 28: Fuqizimi i kapaciteteve të formimit profesional nëpërmjet rikonstruksionit të dhe fuqizimit të qendrës së formimit Nr. 4 në Tiranë.

Analizë

Për zbatimin e masës 27 raportohet se 17 shtetas të rikthyer kanë marrë trajnime për formim profesional dhe se janë aprovuar kurrikula për trajnime për shtetasit e rikthyer për profesionet riparim panelesh diellorë, berber dhe rrobaqepës. Së pari, numri i atyre që përfitojnë nga këto programe është mjaft i vogël dhe së dyti nuk specifikohet nëse këta përfitues ju përkasin ose jo shtetasve të rikthyer me probleme ekonomike.

Masa 28 raportohet e pa-zbatuar. Megjithatë përtej kësaj ajo ka një qëllim shumë të ngushtë dhe fokusohet thjesht në një qendër të trajnimit profesional. Rrjedhimisht edhe kur të zbatohet ndikimi i saj do të jetë i kufizuar.

Objektivi 3.4: Mbështetja e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer në Shqipëri në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe profesional përmes informacionit dhe shërbimeve.

- Masa 29: Përcaktimi në Rregulloren e funksionimit të Drejtorive Arsimore Rajonale (DAR) dhe Zyrave Arsimore (ZA) i detyrave për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer dhe modaliteteve të bashkëpunimit me të gjitha institucionet lokale që veprojnë në ndihmë të këtyre shtetasve.
- Masa 30: Hartimi i kurrikulës së veçantë për mësimin plotësues të gjuhës shqipe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nga MASH përmes Institutit të Zhvillimit të Arsimit. Gjatë këtij procesi do të mbahen parasysh diferencat e mundshme të shkollës jashtë vendit në vendet kryesore të destinacionit të emigrantëve shqiptarë, me programet që ofron sistemi arsimor shqiptar.
- Masa 31: Organizimi i shkollave verore ku të marrin pjesë edhe kjo kategori fëmijësh për mësimin plotësues të gjuhës shqipe.
- Masa 32: DAR dhe ZA në planin vjetor të punës përfshijnë shprehimisht detyrat e mëposhtme: Sektori i statistikave evidenton dhe raporton pe-



riodikisht në MASH për ardhjen dhe sistemimin në institucionet e arsimit parauniversitar të fëmijëve të shtetasve shqiptarë të rikthyer; Sektori i Kurrikulave dhe Cilësisë do të ketë të gatshme programet mësimore në ndihmë të këtyre fëmijëve duke evidentuar nevojat sipas grupmohave; Sektori i Kurrikulave dhe Cilësisë bashkëpunon me IZHA dhe OJF të specializuara që ofrojnë programe trajnimesh për këtë kategori nxënësish.

- Masa 33: Agjencia Kombëtare për Arsimin dhe Trajnimin Profesional së bashku me institucione të specializuara vendas edhe të huaja të bëjë përshtatjen e politikave kurrikulare me nevojat e të kthyerve për arsimin dhe formimin profesional.

Analizë

Masa 29 theksohet se është zbatuar nëpërmjet hartimit të një urdhri të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Megjithatë, ajo kryesisht merret me ndryshime legjislative dhe nuk ka ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë në ri-integrimin e shtetasve të rikthyer në sistemin arsimor.

Për masën 30 raportohet se është nxjerrë një urdhër i Ministrit të Arsimit si dhe se janë hartuar kurrikulat përkatëse për marrjen e mësimeve shtesë në gjuhën dhe kulturën shqipe që prej vitit 2010. Së pari edhe kjo masë synon kryesisht ndryshime ligjore. Së dyti edhe pse nuk thuhet drejtpërdrejt në raportim duket se synohet që ofrimi i klasave shtesë të kryhet brenda programeve ekzistues dhe së treti nuk raportohet asnjë e dhënë konkrete mbi ndikimin e kësaj mase për ri-integrimin e shtetasve shqiptarë të rikthyer në arsim.

Për zbatimin e masës 31 janë organizuar 6 shkolla verore në katër rrethe dhe 50 fëmijë shtetasish të rikthyer janë integruar në to. Kjo masë nuk përfshin ndonjë ndërhyrje konkrete për shtetasit e rikthyer, por thjesht kryen integrimin e tyre në programet ekzistuese.

Lidhur me masën 32 përmendet se është nxjerrë një urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës i vitit 2011 i cili detyron DAR dhe ZA që të përfshijnë detyrat që përcakton kjo masë në planin e tyre vjetor të punës. Për më tepër, theksohet se DAR nuk kanë identifikuar ndonjë nevojë specifike për fëmijët e shtetasve të rikthyer dhe se si rrjedhojë nuk është kryer ndonjë program shtesë për trajnim. Kjo masë përfshin integrimin e fëmijëve të shtetasve të rikthyer në ndonjë program të ri sipas nevojave të tyre. Për më tepër, e gjithë masa përfshin shumë pak ndërhyrje praktike dhe përqendrohet më së shumti tek përshtatja e ligjeve dhe rregulloreve.

Për zbatimin e masës 33, janë hartuar 44 kurrikula për trajnimin pro-

fesional për të mundësuar trajnimin profesional për shtetasit e rikthyer. Megjithatë, nuk specifikohet se si janë vlerësuar nevojat e shtetasve të rikthyer si dhe mungon informacioni mbi ndikimin e kësaj mase.

Objektivi 3.5: Mbështetja e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer në Shqipëri në sistemin shëndetësor, sigurimet shëndetësore dhe mbrojtjes sociale.

- Masa 34: Orientimi përmes punonjësve socialë në Drejtoritë e Shëndetit Publik. Trajnimi i punonjësve socialë lidhur me shërbimet ndaj shtetasve shqiptarë të kthyer. Përgatitja e manualit përkatës.
- Masa 35: Informimi dhe ofrimi i imunizimit dhe profylaksisë sipas historisë së udhëtimeve dhe gjeografisë së qëndrimit dhe udhëtimit.
- Masa 36: Informimi, analiza dhe dhënia e përfitimit shtetasve shqiptarë të kthyer të pagesave me para në dorë dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore.

Analizë

Lidhur me masën 34, theksohet se shtetasve të rikthyer iu jepet ndihmë psiko-sociale nëpërmjet Shërbimit Psiko-social dhe atij për shëndetin mendor sikundër edhe pjesës tjetër të popullsisë.

Për zbatimin e masës 35 raporti thekson se të gjithë qendrat për përkujdesjen e fëmijëve në Shqipëri japin informacion, imunizim dhe vaksinim për shtetasit e rikthyer, sikundër vepohet edhe me pjesën tjetër të popullsisë si edhe jep të dhëna mbi numrin e shtetasve të rikthyer që janë regjistruar tek mjeku i familjes dhe mbi fëmijët e shtetasve të rikthyer që vazhdojnë kalendarin e vaksinimit.

Për masën 36 raporti jep të dhëna mbi numrin e të rikthyerve që kanë përfituar nga ndihma ekonomike në përgjithësi dhe në rajone të ndryshme.

Masat 34, 35 dhe 36 nuk përmbajnë ndonjë ndërhyrje specifike për shtetasit e rikthyer, por synojnë kryesisht integrimin e tyre në shërbimet shëndetësore dhe ato të ndihmës ekonomike që ofrohen dhe për pjesën tjetër të popullsisë. Për më tepër, kur flitet për ndihmën ekonomike në masën 36 raportimi bëhet konfuz, pasi një herë flet për shtetas dhe një herë për familje.



Objektivi 3.6: Mbështetja e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes ofrimit të mbështetjes psiko-sociale në rastet kur nevojitet.

- Masa 37: Ofrimi i shërbimit psikologjik të sistemit arsimor ndaj fëmijëve të kthyer në përshtatshmërinë e tyre me shkollën, në marrëdhëniet mes komunitetit të nxënësve si edhe në marrëdhëniet mes tyre dhe personelit mësimdhënës.

Analizë

Për masën 37 raportohet se psikologët e shkollave janë trajnuar për të ofruar trajnim për shtetasit shqiptarë të rikthyer dhe se iu është ofruar ky shërbim 52 shtetasve. Edhe pse shërbimi psikologjik për fëmijët e shtetasve të rikthyer nëpër shkolla është një masë e nevojshme, edhe në këtë rast ata trajtohen brenda kuadrit ekzistues ku trajtohen edhe fëmijët e tjerë.

Objektivi 3.7: Mbështetja e ri integrimit të shtetasve të kthyer përmes ofrimit të informacionit, mbi programet vendore të strehimit; lehtësim-it dhe shpejtimit të zgjidhjes së përkohshme për rastet më problematike dhe emergjente dhe sigurimi i zgjidhjeve afatgjatë nëpërmjet programeve sociale të strehimit.

- Masa 38: Ndryshime në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" me synim zgjidhjet e përkohshme për rastet emergjente. Planifikimi i fondeve për bonusin e strehimit për rreth 50/familje/persona.
- Masa 39: Sigurimi i informacionit të nevojshëm për shtetasit shqiptarë të rikthyer mbi programet vendore të strehimit në koordinim me institucionet e tjera dhe njësitë vendore: përgatitja e informacionit e rreth 160,000 fletëpalosjeve; bashkërendimi me institucionet e tjera për përfshirjen e informacionit në fletëpalosje, informimi i nevojshëm për njësitë e qeverisjes vendore.

Analizë

Masa 38 raportohet si në proces. Përtej faktit se projektligji është çuar brenda afatit për miratim në Këshillin e Ministrave, nuk jepet asnjë e dhënë lidhur me zbatimin ose jo të fondit të strehimit për 50 familje shtetasish të rikthyer. Në tërësi mund të thuhet se edhe kjo masë ka karakter normativ dhe nuk përmban ndërhyrje konkrete që trajtojnë nevojat për strehim të shtetasve të rikthyer.

Për masën 39 raporti thekson se 5,000 broshura janë përgatitur për mundësitë për informimin e shtetasve të rikthyer mbi programet vendore

të strehimit. Së pari, numri i fletëpalosjeve të përgatitura nuk korrespondon me numrin e planifikuar. Së dyti, edhe kjo masë nuk synon ndonjë ndërhyrje konkrete por mjaftohet thjesht me informim.

Objektivi 3.8: Mbështetja e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer nga zonat rurale përmes programeve për nxitjen e investimeve në bujqësi.

- Masa 40: Përfshirja e shtetasve shqiptarë të rikthyer nga zonat rurale në programet për nxitjen e investimeve në bujqësi.

Analizë

Për masën 40 raporti thekson se gjatë vitit 2011 asnjë shtetas shqiptar nuk ka aplikuar për ndonjë skemë për nxitjen e investimeve në bujqësi. Prandaj mund të thuhet se kjo masë nuk ka asnjë ndikim konkret tek ri-integrimi i shtetasve shqiptarë të rikthyer.

Objektivi 3.9: Mbështetja e ri-integrimit të shtetasve shqiptarë të kthyer përmes bashkëpunimit me shoqërinë civile.

- Masa 41: Krijimi i një data baze pranë SM mbi projektet që aplikohen nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare në qarkun përkatës për shtetasit shqiptarë të kthyer.
- Masa 42: Orientimi i shtetasve shqiptarë të kthyer drejt organizatave lokale dhe ndërkombëtare që trajtojnë problemet e tyre.

Analizë

Për zbatimin e masës 41 thuhet se data baza me shoqata që ofrojnë shërbime për emigrantët e rikthyer janë ngritur në 4 rrethe nga 22 gjithsej. Për sa i përket kësaj mase, pavarësisht faktit se në disa rrethe mund të mos ketë shoqata të cilat ofrojnë shërbime, nevojitet një shtrirje më e madhe e kësaj databaze.

Për masën 42 raporti i monitorimit ofron detaje mbi orientimin e shtetasve të rikthyer drejt shoqatave që veprojnë në rajone të ndryshme të Shqipërisë, të cilat ofrojnë programe për nxitjen e punësimit, programe të trajnimit profesional si edhe shërbime sociale të tjera.



LITERATURA

Chachipe, 'Selective freedom: The visa liberalization and restrictions to travel in the Balkans.' June 2012, [Online]: http://romarights.files.wordpress.com/2012/07/chachipe_visa_liberalisation_report_270612.pdf. Parë në tetor 2012.

Council of the European Union, 'Council regulation amending Regulation (EC) No.539/2001 listing the third countries Whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement.' Decision 15521/09, [Online]: http://www.esiweb.org/pdf/schengen_white_list_project_Council%20decision%20giving%20Macedonia,%20Montenegro%20and%20Serbia%20visafree%20travel%20%2830%20November%29.pdf. Parë në tetor 2012.

Council of the European Union, 'Visa Liberalization for Albania and Bosnia Herzegovina.' Decision 15875/10, [Online]: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/jha/117555.pdf. Parë në tetor 2012.

EU Business online, 'Foul play behind surge in Albanian Asylum seekers.' 18 October 2011, [Online]: <http://www.eubusiness.com/news-eu/albania-belgium.cyr>. Parë në tetor 2012.

European Commission, 'First report on post-visa liberalization monitoring for the Western Balkan countries in accordance with the Commission Statement of 8 November 2010.' Brussels, 1.6.2011, [Online]: <http://register.consilium.europa.eu/pdf/en/11/st10/st10997.en11.pdf>. Parë në shtator 2012.

European Commission, 'Second report on post visa liberalization in accordance with the Commission statement of 8 November 2010.' Brussels 7.12.2011, [Online]: http://www.europarl.europa.eu/registre/docs_autres_institutions/commission_europeenne/sec/2011/1570/COM_SEC%282011%291570_EN.pdf. Parë në shtator 2012.

European Commission, 'Third report on post-visa liberalization monitoring for the Western Balkan countries in accordance with the commission

statement of 8 November 2010.' Brussels, 28.8.2012, [Online]: <http://eu-rlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2012:0472:FIN:EN:PDF>. Parë në tetor 2012.

European Commission, 'Albanian 2011 progress report.' October 2011, [Online]: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/al_rapport_2011_en.pdf. Parë në tetor 2012.

European Training Foundation, 'The contribution of human resources development to migration policy in Albania.' December 2007, [Online]: <http://www.etf.europa.eu/web.nsf/%28RSS%29/C125782B0048D6F6C12573DBoo4C8C94?OpenDocument&LAN=en>. Parë në tetor 2012.

European Stability Initiative, 'Why visa liberalization in the Western Balkans remains a success.' December 2011. [Online]: http://www.novisa.md/uploads/2011/04/schengen_white_list_project_compendium.pdf. Parë në tetor 2012.

Eurospeak 'Asylum requests, serious risk for visa liberalization regime.' No 12, October-December 2012, [Online]: <http://www.em-al.org/skedaret/1353504524-EuroSpeak%20No.%2012.pdf>. Parë në tetor 2012.

Eurostat, 'Concepts and definitions.' [Online]: http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_NOM_DTL_GLOSSARY&StrNom=CODED2&StrLanguageCode=EN. Parë në janar 2013.

Frontex, 'Western Balkans Annual Risk Analysis.' December 2011, [Online]: http://frontex.europa.eu/assets/Attachments_News/wb_ara_2011_for_public_release.pdf. Parë në tetor 2012.

Frontex, 'FRAN Q2 2012.' April 2012, [Online]: http://www.frontex.europa.eu/assets/Publications/Risk_Analysis/FRAN_Q2_2012_.pdf. Parë në shtator 2012.

Gazeta Shekulli, 'Belgjika ri-kthen nw Tiranw 54 azilkwrkues' 24 tetor 2012, [Online]: <http://shekulli.com.al/web/p.php?id=6569&kat=87>. Parë në tetor 2012.

Gedeshi, I and De Zwager, N. 'Effects of global crisis on migration and remittances in Albania.' in The World Bank, 'Migration, and remittances during the global crisis and beyond.' April 2012, Chapter 19 pp. 237-254 [Online]: http://publications.worldbank.org/index.php?main_page=product_info&products_id=24219. Parë në shtator 2012.

Immigration and Refugee Board of Canada, 'Albania: Statistics on blood feuds; state protection and support services available to those affected

by blood feuds, including whether individuals have been prosecuted for blood-feud-related crimes (2007 – September 2010).', 15 October 2010, [Online]: <http://www.unhcr.org/refworld/country,,,,ALB,,4dd10ee72,o.html>. Parë në dhjetor 2012.

Immigration and Refugee board of Canada, 'Albania: attestation letters for blood feud; issuing organizations; how letters are issued processed and stored; whether issuing organizations are recognized by the government, whether the CNR has the full authority, approved by the government and recognized by international organizations to verify the authenticity of blood feuds; fees for mediation services' issuance of false attestation letters.' 1 February 2012, [Online]: <http://www.unchr.org/refworld/docid/4f5f1ab32.htm> Parë në dhjetor 2012

Office of the Commissioner General for Refugees and stateless persons, 'Asylum statistics Monthly Report, May 2012.' Table d. Applications in 2009, 2010, 2011, and 2012 according to nationality.' May 2012, [Online]: http://emnbelgium.be/sites/default/files/attachments/asylum_statistics__may_2012_eng.pdf. Parë në tetor 2012.

Republika e Shqipërisë, 'Strategjia për ri-integrimin e Shtetasve Shqiptarë të rikthyer 2010-2015.' Qershor 2010, [Online]: <http://www.mpcs.gov.al/images/stories/ministria/mpcsshb/strategy/strategy-on-reintegration-of-returned-albanian-citizens-2010-2015.pdf>. Parë në tetor 2012

Republika e Shqipërisë, Ministria e Punës, çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria për Politikën e Migracionit, Ri-kthimin dhe Ri-integrimin, Sekretariati Teknik 'Raporti i monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Shtetasit Shqiptarë të Rikthyer 2010-dhjetor 2011' (Informacion marrë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta)

UNCHR, 'Report by the Special Rapporteur on the human rights of migrants, François Crépeau, on his mission to Albania, 13 December 2011.' January 2012, [Online]: http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/HRCouncil/RegularSession/Session20/A-HRC-20-24-Add1_sp.pdf. Parë në tetor 2012.

Swedish Migration Board, 'Asylum statistics, 'Swedish Migration Board, current year.' May 2012. [Online]: <http://www.migrationsverket.se/download/18.95fff51133976f7baf800045479/Avgjorda+asyl%C3%A4renden+2012+-+Asylum+desicions+2012.pdf>. Parë në tetor 2012.

UNCHR, 'Origin of Asylum applications lodged in 2010 and 2011.' In UNCHR 'Asylum levels and trends in industrialized countries, 2010-2011' [Online]: http://www.unhcr.se/fileadmin/user_upload/PDFdocuments/2012_News/AsylumTrends2011.pdf. Parë në shtator 2012.

Website of DG Enlargement, [Online]: http://ec.europa.eu/enlargement/about/directorate-general/index_en.htm. Parë në dhjetor 2012.

